VENDIM
Nr.38, datë 18.7.2007

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR FUNKSIONIMIN E REGJISTRIT TË KREDIVE NË BANKËN E SHQIPËRISË"

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 3 paragrafi 2, nenit 12 shkronja "a" dhe nenit 22 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", nenit 127 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", si dhe të ligjit nr.8517, datë 22.7.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Neni 3
Përkufizime

1. Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) Regjistri i Kredive është baza e të dhënave, e mbajtur në mënyrë elektronike, në të cilën regjistrohet informacioni dhe të dhënat identifikuese dhe ato të kreditit të individëve, të personave fizikë tregtarë dhe të atyre juridikë, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.

b) Kredi është marrëdhënia juridike e detyrimit sipas përcaktimit në nënpikën 6 të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

c) Marrëveshje kredie është kontrata midis kredidhënësit dhe kredimarrësit, e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve për livrimin dhe ripagimin e kredisë.

d) Kredimarrësi është individi, personi fizik ose personi juridik, dhe çdo palë tjetër e kontratës së kredisë, i cili ka përfituar kredi nga raportuesit e të dhënave si rezultat i një marrëveshjeje ligjore të lidhur me ta.

e) Raportuesit e të dhënave të Regjistrit të Kredive janë të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja, që janë të licencuara nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë, si dhe subjektet e tjera të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", kur parashikohet me akt nënligjor nga Banka e Shqipërisë. Për qëllime të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë konsiderohet raportuese e të dhënave për kreditë që i jep punonjësve të vet në përputhje me ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë".

f) Të dhëna personale janë të dhënat e përkufizuara si të tilla në ligjin nr.8517, datë 22.7.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe që mbrohen prej tij.

g) Trajtim i të dhënave nënkupton të gjitha veprimet që kryhen për trajtimin e të dhënave, siç parashikohen në ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

h) Klauzola e pëlqimit paraprak është autorizimi me shkrim i lëshuar nga kredimarrësi, gjatë plotësimit të aplikimit për kredi, për trajtimin e të dhënave personale të tij/saj, në përputhje me mënyrën e parashikuar në këtë rregullore.

i) Informacion negativ është informacioni në lidhje me pagesën e vonuar të kësteve (kryegjësë, kamatave dhe/ose penaliteteve) mujore apo të të gjithë kredisë, si dhe çdo formë tjetër shkeljeje e detyrimeve të kredimarrësit në lidhje me marrëveshjen e kredisë.

j) Përdorues të autorizuar të informacionit të Regjistrit të Kredive janë subjektet e përcaktuara në nenin 12, të kësaj rregulloreje.

k) Raporti për kredimarrësin është informacioni i nxjerrë nga Regjistri i Kredive, i cili përmban të dhëna mbi identitetin dhe të kreditit të kredimarrësit.

l) Subjekt i regjistrimit te Regjistri i Kredive janë të gjithë kredimarrësit dhe personat e lidhur me ta, së bashku me totalin e detyrimit të kredisë ndaj raportuesve të të dhënave sipas rregullave dhe mënyrës, të përcaktuar në këtë rregullore.

2. Kurdoherë që në rregullore përmenden fjalët "informacion" dhe "të dhëna", ato përdoren në mënyrë alternative, dhe njëra fjalë do të nënkuptojë tjetrën, sa herë që kjo është e nevojshme nga konteksti.

Neni 4
Qëllimi i Regjistrit të Kredive

Regjistri i Kredive ka për qëllim kryesor:

a) trajtimin e përqendruar të informacionit dhe të të dhënave, në lidhje me ekspozimin kreditor të çdo kredimarrësi dhe personave të lidhur me ta mbi baza individuale dhe të agreguara ose të konsoliduara, veçanërisht ndaj sistemit bankar në Republikën e Shqipërisë, për qëllim të vlerësimit të rrezikut të kredisë nga raportuesit e të dhënave;

b) trajtimin dhe sigurimin e informacionit në lidhje me ekspozimin kreditor të të gjithë kredimarrësve ndaj sistemit bankar në Republikën e Shqipërisë, për qëllim të realizimit të funksionit mbikëqyrës dhe rregullator të Bankës së Shqipërisë.

Neni 5
Parimet e Regjistrit të Kredive

1. Parimi bazë i funksionimit të Regjistrit të Kredive është trajtimi dhe mbrojtja e të dhënave personale dhe e sekretit bankar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Informacioni dhe të dhënat e raportuara në Regjistrin e Kredive nuk transferohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve që parashikohen me ligj.

Neni 6
Autoriteti përgjegjës

Banka e Shqipërisë është autoriteti përgjegjës për administrimin e Regjistrit të Kredive.

KREU II
RAPORTIMI I INFORMACIONIT DHE TË DHËNAVE
QË MBAHEN NË REGJISTRIN E KREDIVE

Neni 7
Raportimi i të dhënave në Regjistrin e Kredive

1. Të gjithë raportuesit e të dhënave raportojnë në Regjistrin e Kredive informacionin dhe të dhënat e përcaktuara në këtë rregullore.

2. Raportuesit e të dhënave, para se të kërkojnë të përdorin apo të raportojnë informacionin dhe të dhënat e përcaktuara në këtë rregullore për qëllime të Regjistrit të Kredive, duhet të autorizohen paraprakisht me shkrim nga kredimarrësi.

3. Autorizimi me shkrim nga kredimarrësi jepet kur nënshkruan formularin e aplikimit për kredi, i cili duhet të ketë në tekstin e tij ose të bashkëlidhur klauzolën e pëlqimit paraprak.

4. Klauzola e pëlqimit paraprak duhet të përmbajë të paktën elementet e njoftimit të subjektit të regjistrimit, të parashikuara në ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

5. Klauzola e pëlqimit paraprak është e vlefshme për të gjithë kohën e vlefshmërisë së marrëveshjes së kredisë.

Neni 8
Të dhëna që nuk trajtohen në Regjistrin e Kredive

Regjistri i Kredive nuk trajton të dhëna në lidhje me kreditë që bankat ose degët e bankave të huaja i japin njëra tjetrës, si dhe me kreditë që bankat ose degët e bankave të huaja i japin Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, ose të dhëna në lidhje me kreditë që Banka e Shqipërisë i jep raportuesve të të dhënave dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në përputhje me ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë".

Neni 9
Përmbajtja e Regjistrit të Kredive

Informacioni i cili mbahet në Regjistrin e Kredive për çdo kredimarrës dhe klauzola e pëlqimit paraprak, përcaktohen me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë.

Neni 10
Periodiciteti i raportimit

Raportuesit e të dhënave të Regjistrit të Kredive raportojnë informacionin dhe të dhënat e parashikuara në nenin 9 të kësaj rregulloreje:

a) brenda ditës, për çdo kredi të re të lëvruar; dhe

b) brenda 15 ditëshit të parë të muajit pasardhës, për gjendjen e portofolit të kredive bashkë me klasifikimet e tyre përkatëse.

Neni 11
Përgjegjësia për saktësinë e informacionit dhe të të dhënave

1. Raportuesit e të dhënave, të cilët raportojnë informacion dhe të dhëna në përputhje me nenin 9 të kësaj rregulloreje janë përgjegjës për saktësinë dhe plotësinë e informacionit dhe të të dhënave të raportuara, dhe marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar saktësinë dhe plotësinë e informacionit dhe të të dhënave të raportuara.

2. Nëse raportuesi i të dhënave zbulon se ndonjë prej informacioneve ose të dhënave të raportuara janë të pasakta ose të paplota, njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë, kryen korrigjimin e informacioneve ose të të dhënave të pasakta apo të paplota dhe i raporton ato përsëri në Regjistrin e Kredive.

3. Nëse Banka e Shqipërisë vëren se informacioni dhe të dhënat e raportuara apo të ruajtura në Regjistrin e Kredive janë të pasakta, raportuesi i të dhënave duhet të shpjegojë arsyen e pasaktësisë dhe merr të gjitha masat e nevojshme për korrigjimin e menjëhershëm të informacionit apo të të dhënave të pasakta.

KREU III
MËNYRA DHE KUSHTET E PËRDORIMIT TË INFORMACIONIT DHE TË TË DHËNAVE TË REGJISTRIT TË KREDIVE

Neni 12
Përdoruesit e autorizuar të informacionit dhe të të dhënave

Përdorues të autorizuar të informacionit dhe të të dhënave që mbahen në Regjistrin e Kredive janë:

a) raportuesit e të dhënave të Regjistrit të Kredive;

b) Banka e Shqipërisë.

Neni 13
Kushtet e marrjes së informacionit dhe të të dhënave nga Regjistri i Kredive

1. Informacioni dhe të dhënat e mbajtura në Regjistrin e Kredive përbëjnë sekret bankar dhe

duhen trajtuar dhe ruajtur si të tilla nga të gjithë përdoruesit e autorizuar të tij.

2. Banka ose dega e bankës së huaj nuk do të konsiderohet se ka shkelur detyrimin për ruajtjen e informacionit të klientit, të parashikuar në nenin 125 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", për të dhënat që raporton në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

3. Përdoruesit e autorizuar të të dhënave janë përgjegjës për shkeljen e detyrimit të ruajtjes së informacionit të klientit të parashikuar në nenin 125 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", kur e përdorin informacionin dhe të dhënat e përfituara nga Regjistri i Kredive në kundërshtim me kërkesat ose jashtë qëllimeve të kësaj rregulloreje.

4. Banka e Shqipërisë siguron kopje të raportit për kredimarrësin:

a) për përdoruesit e autorizuar, për qëllime të lidhjes dhe përmbushjes së një marrëveshjeje kredie, në të cilën personi rreth të cilit kërkohet informacioni është palë;

b) në përmbushje të një detyrimi ligjor apo të një vendimi gjykate;

c) për qëllime të tjera, të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë.

5. Regjistri i Kredive nuk regjistron apo trajton të dhëna personale sensitive me të cilat do të kuptohen të dhëna të tilla si:

a) origjina racore dhe etnike, bindjet dhe përkatësitë politike, bindjet fetare dhe të tjera;

b) gjendja shëndetësore, jeta seksuale dhe gjendja penale.

Neni 14

Përdorimet e palejueshme të informacionit dhe të të dhënave të Regjistrit të Kredive

Përdoruesi i autorizuar i të dhënave është i ndaluar të marrë dhe të përdorë informacionin dhe të dhënat e regjistruara në Regjistrin e Kredive, për t'i ofruar ose reklamuar subjektit të regjistrimit mundësinë e kredimarrjes nëse ky subjekt nuk ka aplikuar për marrjen e një kredie me përdoruesin e autorizuar të të dhënave. Mosrespektimi i këtij ndalimi nga përdoruesi i autorizuar do të konsiderohet si shkelje e kësaj rregulloreje dhe do të trajtohet sipas nenit 17 të kësaj rregulloreje.

Neni 15

Kohëzgjatja e mbajtjes së informacionit dhe e të dhënave në Regjistrin e Kredive

1. Banka e Shqipërisë mban në Regjistrin e Kredive informacionin dhe të dhënat e raportuara nga raportuesit e të dhënave, për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e kryerjes së pagesës së fundit për shlyerjen e kredisë.

2. Pas mbarimit të afatit 5-vjeçar, informacioni dhe të dhënat negative fshihen nga Regjistri i Kredive.

Neni 16

Detyrimet e raportuesve të të dhënave

1. Raportuesit e të dhënave, para miratimit të kredisë, kërkojnë informacion dhe të dhëna nga Regjistri i Kredive, për çdo subjekt të interesuar që aplikon për të marrë kredi.

2. Raportuesit e të dhënave, nëpërmjet akteve të tyre të brendshme rregullojnë procedurat e raportimit dhe marrjes së informacionit dhe të të dhënave për kredimarrësit e tyre, procedurat për korrigjimin e të dhënave të pasakta ose të paplota, si dhe procedura të tjera që raportuesit e të dhënave i gjykojnë të nevojshme.

3. Raportuesit e të dhënave marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar dhe ruajtur informacionin dhe të dhënat që raportojnë në Regjistrin e Kredive nga dëmtimet apo nga përdorimet e paautorizuara.

Neni 17

Masat ndëshkimore

1. Banka e Shqipërisë, në rast shkeljeje të dispozitave të kësaj rregulloreje nga raportuesit e të dhënave, merr masa ndëshkimore të parashikuara në nenin 89 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

2. Do të konsiderohen shkelje të kësaj rregulloreje, përveç të tjerash, veprimet e mëposhtme:

a) mosdërgimi i informacionit dhe i të dhënave brenda periudhës kohore të përcaktuar në këtë rregullore;

b) raportimi i informacionit ose i të dhënave që dihet se janë të pasakta ose të rreme;

c) përdorimi i paautorizuar ose keqpërdorimi i informacionit dhe i të dhënave;

d) shkelja e konfidencialitetit të informacionit dhe e të dhënave (unauthorized disclosure);

e) mosrespektimi i afatit 10 - ditor lidhur me të drejtën e informimit, përcaktuar në nenin 19 të kësaj rregulloreje.

3. Marrja e masave ndëshkimore nga Banka e Shqipërisë ndaj raportuesit të të dhënave, nuk përjashton përgjegjësinë civile apo penale, të parashikuar nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 18

Tarifat për përdorimin e informacionit dhe të të dhënave të Regjistrit të Kredive

1. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor tarifat për përdorimin e informacionit dhe të të dhënave, që mbahen në Regjistrin e Kredive.

2. Tarifat janë subjekti i rishikimit periodik nga Banka e Shqipërisë.

Neni 19

E drejta e informimit rreth informacionit dhe të dhënave

1. Kredimarrësi ka të drejtë të kërkojë nga raportuesi i të dhënave, kopje të informacionit apo të të dhënave që ky fundit mban për të.

2. Raportuesit e të dhënave duhet të sigurojnë kopje të informacionit apo të të dhënave të kërkuara, brenda 10 ditësh nga depozitimi i kërkesës te këta të fundit.

Neni 20

E drejta e për të kërkuar korrigjimin e informacionit dhe të të dhënave të Regjistrit të Kredive

1. Çdo individ, person fizik ose juridik, ka të drejtë të kërkojë korrigjimin e informacionit dhe të të dhënave të pasakta ose të paplota që mbahen rreth tij në Regjistrin e Kredive, sipas mënyrës së përcaktuar në dispozitat e ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Të drejtën për të kërkuar korrigjimin e informacionit apo të të dhënave të pasakta ose të paplota e ka edhe Banka e Shqipërisë, në rastet e parashikuara në nenin 11 të kësaj rregulloreje.

2. Raportuesi i të dhënave, përgjegjës për raportimin e pasaktë apo të paplotë kryen korrigjimin e informacionit apo të të dhënave dhe e raporton përsëri atë në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 11, të kësaj rregulloreje.

3. Banka e Shqipërisë, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, merr masat e nevojshme tekniko-administrative për përshtatjen dhe rregullimin e veprimtarisë së Regjistrit të Kredive, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga pika 1 e këtij neni.

KREU IV

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 21

Raportet dhe procedurat operacionale

Banka e Shqipërisë nxjerr aktet e nevojshme nënligjore, ndërmjet të tjerash, në lidhje me:

a) mënyrën dhe formatin e raportimit të informacionit dhe të të dhënave në Regjistrin e Kredive;

b) formatin, përmbajtjen dhe mënyrën e marrjes së raportit për kredimarrësin nga Regjistri i

Kredive;

c) procedurat operacionale të Regjistrit të Kredive.

Neni 22

Publikime për qëllime statistikore

Banka e Shqipërisë mund të publikojë informacionin dhe të dhënat e mbajtura në Regjistrin e Kredive për qëllime statistikore, mbi baza të konsoliduara dhe duke garantuar anonimatin e tyre, pa veçuar raportues të dhënash ose kredimarrës të caktuar.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Rregullorja “Për funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë” hyn në fuqi në datën 1 janar 2008.

KRYETARI

Ardian Fullani